



TRANSPAROMETRI KOMUNAL

PRIZREN, PEJË, GJAKOVË, SUHAREKË, RAHOVEC, DEÇAN
JANAR – DHJETOR 2018

JANAR 2019, PRIZREN.





TRANSPAROMETRI KOMUNAL

PRIZREN, PEJË, GJAKOVË, SUHAREKË, RAHOVEC, DEÇAN
JANAR – DHJETOR 2018

COPYRIGHT © 2019. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 38,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Përgaditur nga: Naim Cahanaj

Me asistencë hulumtuese nga: Almedin Fejza

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e The Olof Palme Center. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
METODOLOGJIA.....	7
RËNDËSIA DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE.....	7
PËRZGJEDHJA E KOMUNAVE	8
RENDITJA E KOMUNAVE	9
TRANSPARENCA NË KOMUNË.....	13
TRANSPARENCA NË GJAKOVË	14
TRANSPARENCA NË RAHOVEC	16
TRANSPARENCA NË PEJË.....	19
TRANSPARENCA NË PRIZREN.....	22
TRANSPARENCA NË SUHAREKË.....	25
TRANSPARENCA NË DEÇAN	28
REKOMANDIMET	30
ANEKSET. INDIKATORËT DHE KOMENTET	34



HYRJJE

Transparenca është element përbërës i demokracisë lokale dhe u ndihmon qytetarëve që t'i njohin, kuptojnë dhe miratojnë ose plotësojnë politikatat, procedurat dhe veprimet e komunës së tyre. Transparenca kupton hapje, komunikim, llogaridhënie dhe përgjegjshmëri. Transparenca ka të bëjë me të qenurit të hapur dhe të shohësh përtej diçka. Që diçka të jetë transparente do të thotë që është e hapur, mund të qaset lehtë, të shqyrtohet dhe të shihet përtej¹.

Mekanizmi më i mirë në krijimin e një qeverisje lokale demokratike dhe llogaridhënese është zhvillimi i një sistemi i karakterizuar që siguron transparencë në proceset vendimmarrëse dhe ekzekutimit të detyrave. Transparenca si një tregues i qeverisjes së mirë në thelbin e saj simbolizon dukshmërinë ose qasjen e publikut në proceset vendimmarrëse, në kuptimin e saj qeverisja transparente do të thotë një qeverisje në të cilën të gjitha informatat janë në dispozicion për publikun.

Në kontekstin e bazës ligjore për transparencë në Komuna, vendi ynë ka një kornizë solide e cila garanton institucione transparente në funksion të qytetarëve të saj. Kushtetuta, ligji për vetëqeverisjen lokale, ligji për qasjen në dokumente publike janë dokumentet themelore që përcaktojnë transparencën e institucioneve lokale. Normalisht me jo më pak rëndësi janë edhe aktet dhe konventat ndërkombëtare si Karta e Evropiane e për Vetëqeverisjen Lokale, të cilat Kosova edhe pse ende nuk është palë nënshkruese i ka pranuar si akte të zbatueshme në legjislacionin vendor.

Me qëllim të përmirësimit të këtij procesi KDI në kuadër të projektit për monitorimin e institucioneve lokale (Prizren, Pejë, Gjakovë, Suharekë, Rahovec dhe Deçan) ka vazhduar me matjen e transparencës së këtyre institucioneve karshi publikut. Kjo matje realizohet përmes një indeksi i cili ngërthen në vete 59 indikatorë matës të transparencës komunale.

Përmes këtyre indikatorëve provohet të silllet një metodologji të lehtë dhe objektive për matje të transparencës në komuna dhe gatishmërinë e zyrtarëve lokal për të qenë të hapur ndaj publikut dhe gjithëpërfshirës në vendimmarrje. Pra, Transparometri përbën në vete një mekanizëm të krahasimit të transparencës së qeverive lokale të udhëhequra nga subjekte të ndryshme politike.

1 Doracak, Transparenca lokale & pjesëmarrja publike, Iniciativa për Komuna Efektive, dhjetor 2009



METODOLOGJIA

Vlerësimi i Transparometrit ndjek një metodologji të matjes së indikatorëve në mënyrë objektive përgjatë katër shtyllave themelore të qeverisjes lokale. Ky indeks përbëhet nga 59 indikatorë dhe matë transparencën në Zyrën e Kryetarit/es (15 indikatorë), Kuvendin e Komunës (20 indikatorë), Financat Komunale (8 indikatorë) dhe transparencën në Konsultime me Publikun (16 indikatorë).

Rezultati maksimal për një komunë duke përfshirë të gjitha shtyllat është 118 pikë. Secili tregues merr 0 deri në 2 pikë. Pyetjet në metodologjinë janë kryesisht të mbyllura dhe mundësojnë përgjigje po / jo. Varësisht se sa plotësisht është shpalosur informacioni i kërkuar, poentimi i materialit duhet të jetë nga 0 pikë (asnjë informacion) deri në 1 pikë (pjesërisht i shpalosur) ose 2 pikë (informacioni është shpalosur plotësisht).

Metoda e vlerësimit e përdorur për të dhënë një numër të caktuar pikësh:

A — konkludimi analitik i ekipit hulumtues;

D — sigurimi i standardeve të pajtueshmërisë të miratuara nga UA 01/2015 i MAPL², UA 01/2015 i MAP³, Ligji nr.04/L-042⁴, Ligji nr.03/L-040⁵, Ligji nr.03/L-048⁶, Rregullore nr.02/2015 e MPMS⁷, dhe Vendimi i Qeverisë nr. 07/87⁸; Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/2015⁹.

Ë — analiza e ueb faqes. Hulmtimi tregon qartë se ekziston informacioni i mjaftueshëm në ueb faqen zyrtare ose në burime të tjera zyrtare të internetit;

I — përgjigja në letrën e kërimit të informacionit

T — Të dhënat nga interneti;

M — Takimi i drejtpërdrejtë dhe intervistat me qeverinë lokale

Indikatorët janë përzgjedhur me kujdes duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat nën qeverisjen lokale që përcaktohen me ligjet në fuqi. Indikatorët prekin përgjegjësitë bazike të qeverive lokale, aty ku transparenca duhet të jetë e garantuar, dhe nuk shkon në thellësi të matë transparencën edhe në disa sektorë specifik që janë nën kompetencën e komunës si transparenca në shëndetësi, arsim apo planifikim urban. Para se të fillojë vlerësimi i transparencës komunale me indikatorë, KDI ka ndarë dhe diskutuar pyetësorin me zyrtarët për informim të komunave.

RËNDËSIA DHE VLERËSIMI I INDIKATORËVE

Rëndësia dhe pesha e indikatorëve është përcaktuar varësisht nga ndikimi që mund të ketë në kontekstin e transparencës së institucioneve komunale. Rezultati maksimal për një komunë duke përfshirë të gjitha shtyllat është 118 pikë. Secili tregues merr 0 deri në 2 pikë. Pyetjet në metodologjinë janë kryesisht të mbyllura dhe mundësojnë përgjigje po / jo. Varësisht se sa plotësisht është shpalosur informacioni i kërkuar, poentimi i materialit duhet të jetë nga 0 pikë (asnjë informacion) deri në 1 pikë (pjesërisht i shpalosur) ose 2 pikë (informacioni është shpalosur plotësisht).

2 Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 01/2015 për transparencë në komuna : <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11403>

3 Udhëzim Administrativ (MAP) nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike: [https://map.rks-gov.net/getattachment/04a69d9b-2b96-4ef2-bfc7-4c82cb860384/Udhezimi-Administrativ-\(MAP\)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx](https://map.rks-gov.net/getattachment/04a69d9b-2b96-4ef2-bfc7-4c82cb860384/Udhezimi-Administrativ-(MAP)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx)

4 Ligji nr. 04 / L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

5 Ligji Nr. 03 / L-040 për vetëqeverisjen lokale: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

6 Ligji nr. 03 / L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

7 Rregullore (MPMS) nr.02 / 2015 për kriteret dhe procedurat e përkrahjes financiare për subvencione dhe grante: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11129>

8 Vendimi i Qeverisë 07/87 mbi të dhënat e hapura: http://ëëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_87-te_te_Qeverise_2016.pdf

9 Rregullore (QRK) - nr. 04/2015 për kodin e mirësjelljes në shërbimin civil të republikës së Kosovës: http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_QRK_Nr.042015_per_Kodin_e_Miresjelljes_ne_Sherbimin_Civil_te_Republikes_se_Kosoves_19.pdf

Rëndësia dhe pesha e indikatorëve është përcaktuar varësisht nga ndikimi që mund të ketë në kontekstin e transparencës së institucioneve komunale. Rezultati maksimal për një komunë duke përfshirë të gjitha shtyllat është 118 pikë. Secili tregues merr 0 deri në 2 pikë. Pyetjet në metodologjinë janë kryesisht të mbyllura dhe mundësojnë përgjigje po / jo. Varësisht se sa plotësisht është shpalosur informacioni i kërkuar, poentimi i materialit duhet të jetë nga 0 pikë (asnjë informacion) deri në 1 pikë (pjesërisht i shpalosur) ose 2 pikë (informacioni është shpalosur plotësisht).

Kjo rëndësi e indikatorëve është shprehur në pikë dhe varion nga shtyllat. Pikët maksimale në shtyllën e Kuvendit të Komunës janë 40, pikët maksimale në shtyllën e e Zyrës së Kryetarit/es janë 30, pikët maksimale në shtyllën e Financave Komunale janë 16, pikët maksimale në shtyllën e Konsultime me Publikun janë 32. (shikoni Aneksin 1 me Indikatorët).



Indikatorët prekin përgjegjësitë bazike të qeverive lokale, aty ku transparenca duhet të jetë e garantuar, dhe nuk shkon në thellësi të matë transparencën edhe në disa sektorë specifik që janë nën kompetencën e komunës si transparenca në shëndetësi, arsim apo planifikim urban.

PËRZGJEDHJA E KOMUNAVE

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në kuadër të programit të qeverisjes lokale implementon projektin "Pjesëmarrja e qytetarëve për transparencë dhe llogaridhënie" projekt ky i cili mbështet nga Olof Palme International Center (OPIC). Projekti i tillë ka për synim monitorimin dhe vlerësimin e Kuvendeve të Komunave me qëllim të ndikimit në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga institucionet vetëqeverisëse lokale.

Një nga qëllimet e "Transparometrit" është edhe nxitja e konkurrencës për performancë më të mirë në transparencë. Andaj, në vlerësimin e indeksit që do të shpaloset më poshtë janë të përfshira gjashtë (6) komuna (Prizren, Pejë, Gjakovë, Suharekë, Rahovec, Deçan).



RENDITJA E KOMUNAVE

Në përgjithësi transparenca në komuna (këto të përfshira në studim) ka lënë për tu dëshiruar, duke përfshirë këtu disa nga komunat me kryetarë të rinj. Nga 59 indikatorët matës që përbëjnë këtë indeks, kryesisht në katër fusha thelbësore të qeverisjes lokale, asnjë komunë nuk del të jetë 100% transparente. Kjo tregon që edhe komunat me performancën më të mirë në qeverisje kanë ende punë për të bërë që të jenë plotësisht transparente, së paku në këto çështje thelbësore të qeverisjes që ky indeks i adreson.

Në bazë të gjeturave të këtij indeksi me 59 indikatorë në katër fushat bazike të qeverisjes lokale, të matur për periudhën një vjeçare (2018) del se Komuna e Gjakovës ka qenë komuna më transparente me 99 pikë nga 118 pikë sa është maksimalja apo 83.89%. Pastaj radhiten Komuna e Rahovecit (94 pikë apo 79.66%), Komuna e Pejës (78 pikë apo 66.10%), Komuna e Prizrenit (76 pikë apo 64.40%), Komuna e Suharekës (74 pikë apo 62.71) dhe Komuna e Deçanit me (67 pikë apo 56.77 %).

✓ NIVELI I TRANSPARENCËS KOMUNALE



Gjakovë
99 pikë apo
83.89 %



Pejë
78 pikë apo
66.10 %



Rahovec
94 pikë apo
79.66 %



Prizren
76 pikë apo
64.40 %



Suharekë
74 pikë apo
62.71 %



Deçan
67 pikë apo
56.77 %

 Pikët e arritura



Në shtyllën e "Kuvendit të Komunës" nga 40 pikët sa edhe është maksimalja e vlerësimit, si më transparente del të jetë Komuna e Gjakovës dhe Rahovecit me nga 36 pikë. Komuna e Pejës, Suharekës dhe Deçanit në këtë shtyllë të vlerësimit kanë arrit nga 31 pikë derisa shtylla e kuvendit të komunës së Prizrenit mbetet më pak transparente krahasuar me 5 komunat tjera të cilat ishin pjesë e hulumtimit të transparencës me 29 pikë në total.



Kuvendi i Komunës

Gjakovë



Rahovec



Pejë



Suharekë



Deçan



Prizren



■ Pikët maksimale

■ Pikët e arritura

Në shtyllën e "Zyrës së Kryetarit/es", nga 30 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, si më transparente del të jetë Komuna e Gjakovës me 25 pikë, Komuna e Rahovecit me 22 pikë, Komuna e Suharekës me 18 pikë, Komuna e Prizrenit dhe Pejës me nga 15 pikë dhe e fundit në këtë shtyllë mbetet Komuna e Deçanit me 12 pikë.



Zyra e Kryetarit/es

Gjakovë



Rahovec



Suharekë




Prizren



Pejë



Deçan



■ Pikët maksimale

■ Pikët e arritura

Në shtyllën e "Financave Komunale", nga 16 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, si më transparente del të jetë del të jetë Komuna e Gjakovës dhe Prizrenit me nga 13 pikë, Komuna e Rahovecit me 12 pikë, Komuna e Pejës me 9 pikë, Komuna e Suharekës me 7 pikë si dhe Komuna e Deçanit me 6 pikë.




Financat Komunale

Gjakovë




Prizren




Rahovec




Pejë



Suharekë



Deçan



Pikët maksimale

Pikët e arritura

Në shtyllën e "Konsultimet me Publikun", nga 32 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, si më transparente del të jetë Komuna e Gjakovës me 25 pikë, Komuna e Rahovecit me 24 pikë, Komuna e Pejës me 23 pikë, Komuna e Prizrenit me 19 pikë, Komuna e Suharekës dhe Deçanit me nga 18 pikë.




Konsultimet me Publikun

Gjakovë



Rahovec



Pejë




Prizren



Suharekë



Deçan



Pikët maksimale

Pikët e arritura

TRANSPARENCA NË KOMUNË




TRANSPARENCA NË GJAKOVË (AAK)



Gjakovë
99 pikë apo
83.89 %

VLERËSIMI I
PËRGJITHSHËM



Komuna e Gjakovës del të jetë komuna e parë më transparentë në kuadër të komunave që ishin pjesë e këtij hulumtimi me 99 pikë nga 118 sa është maksimalja apo 83.89 % të nivelit të përgjigjëm bazuar në 59 indikatorë.



“TRANSPARENCA E KUVENDIT TË KOMUNËS”. Kuvendi i Komunës së Gjakovës dhe Rahovecit del të jetë institucioni më transparent në krahasim me komunat tjera të cilat ishin pjesë e këtij hulumtimi me vlerësim të përgjithshëm prej 36 pikë nga 40 sa edhe është maksimumi i pikëve për këtë shtyllë. Nga 20 indikatorë sa ka kjo shtyllë, 17 prej tyre janë vlerësuar me transparencë maksimale, dy nga indikatorët janë vlerësuar pjesërisht transparentë dhe një indikatorë në këtë shtyllë është vlerësuar si jo transparent.

Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2018 nuk ka qenë plotësisht transparentë në publikimin e të dhënave biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të kuvendit të komunës. Po ashtu, të dhënat për kontaktet e institucioneve publike të komunës të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shëndetësore etj, nuk kanë qenë plotësisht të qasshme për publikun përmes ueb faqes së komunës.

Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2018 ka dështuar në ofrimin e informacioneve për qytetarët mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes. Kësisoj, duhet të ofrojë në ueb faqen e saj zyrtare informata të detajuara mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes me qëllim të rritjes së mundësive ku qytetarët mund të adresojnë komente, sygjjerime, propozime dhe rekomandime mbi procesin e hartimit të politikave nga ana e kuvendit të komunës.

Në këtë shtyllë, Komuna e Gjakovës qëndron mirë në 17 nga 20 indikatorët vlerësuese duke marrë pikët maksimale për shkak të transparencës së plotë të treguar gjatë vitit 2018. Me këtë, mund të koloadojmë se Kuvendi i Komunës si organ më i lartë i vetëqeverisjes mbetet një nga organet që promovon transparencë në procesin e vendimmarrjes në këtë komunë.



TRANSPARENCA E ZYRËS SË KRYETARIT/ES.

Kjo shtyllë ngërthen në veti 15 indikatorë vlerësues të transparencës së këtij organi. Nga 30 pikë sa edhe është maksimumi i pikëve, me 25 pikë është vlerësuar transparenca e Zyrës së Kryetarit/es në komunën e Gjakovës dhe në raport me transparencën e Kuvendit të Komunës qëndron më dobët.



Transparenca e Zyrës së Kryetarit/es është vlerësuar në këtë mënyrë pasi që nuk ka publikuar “raportin gjashtëmujor të punës” si dhe nuk ka “hartuar një Rregullore komunale për ngacmimet seksuale”. Në dy nga këta indikatorë, ekzekutivi i komunës është vlerësuar si plotësisht jo transparent.

Mungesa e publikimit të raportit të punës në ueb faqen e komunës minimizon qasjen e qytetarëve në informata mbi punën e ekzekutivit komunal dhe njëkohësisht kryetarin e komunës e bënë jo – llogaridhënës në raport me qytetarët e komunës së Gjakovës. Po ashtu, mungesa e politikave të brendshme për adresimin e ngacmimeve seksuale brenda personelit të komunës mbetet një nga pengesat serioze të kryetarit/es të komunës në adresimin korrekt të ngacmimeve të mundshme seksuale që mund të ndodhin brenda institucioneve komunale.

Përkundër përpjekjeve të mëdha për respektimin e legjislacionit për gjuhët zyrtare në nivel lokal, komuna e Gjakovës është vlerësuar pjesërisht transparente në këtë indikatorë. Ky vlerësim i pjesërishtëm vie si rezultat i asaj se komuna e Gjakovës nuk ka të publikuara në ueb faqen e komunës vendimet e Kryetarit të komunës në gjuhë tjetër zyrtare si dhe disa prej dokumenteve tjera nuk janë të qasshme në gjuhë tjetër të komunës. Kryetari i komunës së Gjakovës duhet të shtoj përpjekjet në respektimin e plotë të legjislacionit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal.



“TRANSPARENCA FINANCIAR E KOMUNËS”. Komuna e Gjakovës në transparencën financiare është vlerësuar me 13 pikë nga 16 pikë sa edhe është maksimalja. Nga 8 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë, komuna e Gjakovës është vlerësuar si plotësisht jo transparente në vetëm një nga indikatorët. Mungesa e publikimit të pronave të marra/dhëna me qira nga komuna është një nga indikatorët i cilët nuk është përm-bushur si i përket transparencës së financave komunale.

Mungesa e transparencës në marrjen/dhënien me qira të pronave nga komuna rrit mundësit e keqpërdorimit të aseteve publike dhe minimizon konkurrencën e palëve të interesuara në procesin konkurrues. Andaj, komuna duhet të shtoj përpjekjet e saj në rritjen e transparencës së dhënies/marrjes së pronave me qira, në publikimin e listës së pronave komunale si dhe listën e pronave të dhëna apo të marra me qira nga ana e komunës.

Transparenca financiare dhe përfshirja e qytetarëve në planifikimet buxhetore mbetet një nga problemet e buxhetimit gjithëpërfshirës. Derisa kjo komunë, në njërin anë ka

avancuar në hartimin dhe publikimin e procesverbaleve nga dëgjimet publike duke listuar kërkesat e qytetarëve për projeksione buxhetore, në anën tjetër nuk ka bërë përpjekje në rritjen e transparencës në lidhje me publikimin e tërësishme të kërkesave që janë marrë parasysh në procesin e konsultimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore. Kjo qasje, ka ulë dukshëm transparencën e komunës në organizimin e dëgjimeve buxhetore si dhe ulë besimin reciprok komunë-qytetarë.



“TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN”. Komuna e Gjakovës ka marrë 25 pikë nga 32 sa është maksimalja në këtë shtyllë. Nga 16 indikatorë sa ka kjo shtyllë, komuna e Gjakovës në 5 indikatorë është vlerësuar si pjesërisht transparente. Hapja e të dhënave “Open Data”, pasqyrimi në formë të lajmeve të memorandumëve me OSHC-n, informata parciale të drejtorive komunale mbi listën e ofrimeve të shërbimeve, materiale të pakta përcjellëse për qytetarët në dëgjimet publike dhe buxhetore si dhe mos përkthimi i gjithë materialeve në të gjitha gjuhët zyrtare gjatë mbajtjes së takimeve publike dhe dëgjimet buxhetore janë ndër indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparente në komunën e Gjakovës.

Krahas vlerësimit si pjesërisht transparente në 5 indikatorët vlerësues, kjo komuna është vlerësuar si tërësisht jo transparente në publikimin e raporteve të ndryshme mbi transparencën e komunës së Gjakovës qoftë nga Organizatat e Shoqërisë Civile qoftë nga institucionet qendrore që kanë për obligim nxjerrjen e raporteve të ndryshme mbi transparencën dhe performancën komunale.




TRANSPARENCA NË RAHOVEC (AAK)



Rahovec
94 pikë
79.66 %

VLERËSIMI I
PËRGJITHSHËM



Komuna e Rahovecit del të jetë komuna e dytë më transparente, me një nivel të transparencës prej 94 pikë nga 118 pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit bazuar në 59 indikatorë apo shprehur në përqindje 79.66 %. Nga 40 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit është vlerësuar me 36 pike bazuar në 20 indikatorë vlerësues dhe mbetet shtylla më transparente në këtë komunë.

Shtylla e dytë më transparente në komunën e Rahovecit mbeten financat publike, ku nga 8 indikatorë vlerësues ka arrit 12 pikë nga 16 pikë sa është edhe maksimalja për këtë shtyllë Shtylla e tretë më e vlerësuar në komunën e Rahovecit mbeten "Konsultimet me Publikun", ku nga 16 indikatorë vlerësues ka arrit 24 pikë nga 32 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë shtyllë. E fundit në vlerësim mbetet shtylla e Zyrës së Kryetarit/es, ku nga 15 indikatorët vlerësues të transparencës ka arrit 22 pikë nga 30 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë shtyllë të vlerësimit.



"TRANSPARENCA E KUVENDIT TË KOMUNËS". Kuvendi i Komunës së Rahovecit dhe Gjakovës mbeten organet më transparente në krahasim me komunat tjera që janë pjesë e

këtij hulumtimi me vlerësim të përgjithshëm prej 36 pikëve nga 40 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë shtyllë. Nga 20 indikatorë vlerësues sa ka kjo shtyllë, 17 prej tyre janë vlerësuar me transparencë maksimale, dy nga indikatorët janë vlerësuar pjesërisht transparentë dhe një indikatorë në këtë shtyllë është vlerësuar plotësisht jo transparent.

Në këtë shtyllë, Komuna e Rahovecit qëndron mirë në 17 nga 20 indikatorët vlerësues duke marrë pikët maksimale për shkak të transparencës së plotë të treguar gjatë vitit 2018. Gjatë kësaj periudhe të vlerësimit të transparencës së kuvendi i komunës, ky institucion ka arrite që për secilën mbledhje të bëhet publikimi i agjendës së takimeve, ka publiku data-bazën si një mekanizëm ku mund të publikohen dhe sigurohen rregulloret e shqyrtuara, aprovuara, ka njoftuar qytetarët me kohë etj.

Kuvendi i Komunës së Rahovecit gjatë vitit 2018 nuk ka qenë plotësisht transparentë në publikimin e të dhënave biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të kuvendit të komunës. Po ashtu, të dhënat për kontaktet e institucioneve publike të komunës të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shëndetësore etj, nuk kanë qenë plotësisht të qasshme për publikun përmes ueb faqes së komunës.



Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2018 ka dështuar në ofrimin e informacioneve për qytetarët mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes. Kësisoj, duhet të ofrojë në ueb faqen e saj zyrtare informata të detajuara mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes me qëllim të rritjes së mundësive ku qytetarët mund të adresojnë komente, sugjerime, propozime dhe rekomandime mbi procesin e hartimit të politikave nga ana e kuvendit të komunës.



"TRANSPARENCA E ZYRËS SË KRYETARIT/E." është vlerësuar me 22 pikë nga 30 pikë sa është maksimalja e pikëve në këtë shtyllë. Ekzekutivi i Komunës qëndron mirë në 9 (shtatë) nga 15 (pesëmbëdhjetë) indikatorë. Publikimi i detajeve biografike të Kryetarit/es dhe drejtorëve/eshave, publikimi i informatave që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë, publikimi i konkurseve dhe kriteret për punësim, publikimi i Planit të punës së Kryetarit/res, publikimi i raportit gjashtë mujor i punës së Kryetarit/res, publikimi i vendimeve të Kryetarit në ueb faqen e komunës etj. janë indikatorët që janë vlerësuar si plotësisht transparente gjatë vitit 2018.

Në 4 (katër) indikatorë tjerë në këtë shtyllë, komuna e Rahovecit është vlerësuar si pjesërisht transparente gjatë vitit 2018. Mungesa e publikimit të një mekanizimi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe përcjella e statusit të kërkesave të tilla, mungesa e publikimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe planet tjera rregullative, mungesa e pasqyrimin në baza javore të takimeve të Kryetarit/res me qytetarët si dhe mungesa e respektimit të plotë të legjislacionit në përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal, kanë qenë indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparentë në këtë shtyllë.

Nga 15 indikatorët që ka kjo shtyllë, në 2 indikatorë vlerësues komuna e Rahovecit ka qenë plotësisht jo transparente gjatë vitit 2018. Mungesa e pasqyrimin të raportit të Kryetarit/res në kuvendin e komunës dhe komisione sipas legjislacionit në fuqi si dhe mungesa e një Rregullores komunal për ngacmimet seksuale. Mungesa e publikimit të raportit të punës në ueb faqen e komunës minimizon qasjen e qytetarëve në informata mbi punën e ekzekutivit komunal dhe njëkohësisht kryetarin e komunës e bënë jo – llogaridhënës në raport me qytetarët e komunës së Rahovecit. Po ashtu, mungesa e politikave të brendshme për adresimin e ngacmimeve seksuale brenda personelit të komunës mbetet një nga pengesat serioze të kryetarit/es të komunës në adresimin korrekt të ngacmimeve të mundshme seksuale që mund të ndodhin brenda administratës komunale.



"TRANSPARENCA FINANCIAR E KOMUNËS" Komuna e Romuna e Rahovecit në transparencën financiare është vlerësuar me 12 pikë nga 16 pikë se edhe është maksimalja e vlerësimit në 8 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë. Nga 8 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë, komuna e Rahovecit është vlerësuar si plotësisht jo transparente në dy nga indikatorët.

Komuna e Rahovecit në këtë shtyllë të vlerësimit, qëndron mirë në 6 (gjashtë) nga 8 (tetë) indikatorët vlerësues. Publikimi i borxhit publik komunal, diskutimi brenda afateve ligjore i raporteve tre mujore të shpenzimeve në kuvendin e komunës, mbajtja e procesverbaleve për regjistrimin e propozimeve të qytetarëve për kërkesat buxhetore, informimi i qytetarëve për takimet e KPF-së, publikimi i informatave mbi të hyrat vetanake të komunës si dhe informimi për ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës, janë 6 (gjashtë) nga indikatorët vlerësues që kanë qenë plotësisht transparente gjatë vitit 2018.

Mungesa e publikimit të pronave të marra/dhëna me qira nga komuna si dhe mungesa e informatave mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve janë dy nga indikatorët të cilët nuk janë përmbushur sa i përket transparencës së financave komunale.

Mungesa e transparencës në marrjen/dhënien me qira të pronave nga komuna rrit mundësit e keqpërdorimit të aseteve publike dhe minimizon konkurrencën e palëve të interesuara në procesin konkurrues. Andaj, komuna duhet të shtoj përpjekjet e saj në rritjen e transparencës së dhënies/marrjes së pronave me qira, në publikimin e listës së pronave komunale si dhe listën e pronave të dhëna apo të marra me qira nga ana e komunës.

Transparenca financiare dhe përfshirja e qytetarëve në planifikimet buxhetore mbetet një nga problemet e buxhetimit gjithëpërfshirës. Derisa kjo komunë, në njërin anë ka avancuar në hartimin dhe publikimin e procesverbaleve nga dëgjimet publike duke listuar kërkesat e qytetarëve për projeksione buxhetore, në anën tjetër nuk ka publikuar një përmbledhje të përgjigjeve mbi statusin e kërkesave të qytetarëve në proceset e dëgjimeve buxhetore. Kjo qasje, ulë transparencën e komunës në organizimin e dëgjimeve buxhetore si dhe ulë besimin reciprok komunë-qytetarë.



“TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN”. GG-jatë vitit 2018, Komuna e Rahovecit ka marrë 24 pikë nga 32 pikë se edhe është maksimalja në këtë shtyllë të vlerësimit. Nga 16 indikatorë sa ka kjo shtyllë, komuna e Rahovecit në 10 indikatorë është vlerësuar si plotësisht transparente, në 5 indikatorë është vlerësuar si pjesërisht transparente dhe në 1 (një indikatorë) është vlerësuar si plotësisht jo-transparente.

Komuna e Rahovecit është vlerësuar si plotësisht transparente në 9 (nëntë) nga 16 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë. Krijimi i një mekanizmi për monitorimin dhe adresimin e ankesave të qytetarëve, konsolidimi i bashkësive lokale, organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit në fuqi, publikimi i raporteve nga konsultime dhe dëgjimet buxhetore etj. Vlen të ceket se komuna e Rahovecit, është njëra ndër komunat e vetme e cila është vlerësuar si tërësisht transparente në publikimin e raporteve për transparencë të realizuara nga akterë të shoqërisë civile.

Të dhënat e pakta në formatin e “Open Data”, informacionet në formë të lajmeve lidhur me memorandumeve me OSHC dhe mos publikimi i tyre në ueb faqen e komunës, të dhënat parciale të drejtorive komunale në listën e ofrimit të shërbimeve që japin për qytetarët, materialet e pakta përcjellëse për qytetarët në dëgjimet publike dhe buxhetore si dhe përkthimet jo adekuate të materialeve në të gjitha gjuhët zyrtare gjatë mbajtjes së takimeve publike dhe dëgjimet buxhetore janë ndër indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparente në komunën e Rahovecit.

Krahas vlerësimit si pjesërisht transparente në 5 indikatorët vlerësues, kjo komuna është vlerësuar si tërësisht jo-transparente në një prej indikatorëve përkatësisht mungesën e ofrimit të një linjë direkt pa pagesë për qytetarët e komunës së Rahovecit.




TRANSPARENCA NË PEJË (LDK)



Pejë
78 pikë apo
66.10%

VLERËSIMI I
PËRGJITHSHËM



Komuna e Pejës del të jetë komuna e tretë më transparente, me një nivel të transparencës prej 78 pikë nga 118 pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit apo 66.10% bazuar në 59 indikatorë. Nga 40 pikë sa është maksimalja e vlerësimit, Kuvendi i Komunës së Pejës është vlerësuar me 31 pike, bazuar në 20 indikatorë vlerësues dhe mbetet shtylla më transparente në këtë komunë. Shtylla e dytë më transparente mbetet "Konsultimet me Publikun" ku nga 32 pikë sa është maksimalja e vlerësimit bazuar në 16 indikatorë, komuna e Pejës është vlerësuar me 23 pikë në total.



"TRANSPARENCA E KUVENDIT TË KOMUNËS". Kuvendi i Komunës së Pejës mbetet organi më transparente në krahasim me shtyllat tjera që kanë qenë pjesë e vlerësimit me 31 pikë nga 40 pikë sa është maksimalja e vlerësimit për këtë shtyllë. Nga 20 indikatorë vlerësues sa ka kjo shtyllë, 14 prej tyre janë vlerësuar me transparencë maksimale, 3 nga indikatorët janë vlerësuar pjesërisht transparentë dhe 3 indikatorë në këtë shtyllë është vlerësuar plotësisht jo transparent.

Gjatë kësaj periudhe të vlerësimit të transparencës së kuvendit të komunës, ky institucion ka arrite që për secilën

mbledhje të bëhet publikimi i agjendës së takimeve, ka publiku data-bazën si një mekanizëm ku mund të publikohen dhe sigurohen rregulloret e shqyrtuara, aprovuara, ka njoftuar qytetarët me kohë, ka publikuar në ueb faqe një historik për komunën e Pejës, ka bërë informimin e qytetarëve në kohë për takimet e Kuvendit të Komunës, ka publikuar Planin e veprimit për transparencë, ka publikuar linçet e videove të mbledhjeve të mbajtura të Kuvendit të Komunës etj.

Kuvendi i Komunës së Pejës gjatë vitit 2018 nuk ka qenë plotësisht transparentë në publikimin e të dhënave biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Po ashtu, të dhënat për kontaktet e institucioneve publike të komunës të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shëndetësore etj, nuk kanë qenë plotësisht të qasshme për publikun përmes ueb faqes së komunës si dhe nuk ka ofruar qasje të plotë në draft Rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës.

Komuna e Pejës gjatë vitit 2018 ka dështuar në ofrimin e informacioneve për qytetarët mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes, nuk ka ofruar organo-gramin e komunës si dhe nuk ka ofruar qasje në ueb faqen në Planin e punës së Kuvendit të Komunës. Kësisoj, duhet të ofrojë në ueb faqen e saj zyrtare informata të detajuara mbi



procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes me qëllim të rritjes së mundësive ku qytetarët mund të adresojnë komente, sugjerime, propozime dhe rekomandime mbi procesin e hartimit të politikave nga ana e kuvendit të komunës.



“TRANSPARENCA E ZYRËS SË KRYETARIT/ES”. Komuna e Pejës është vlerësuar me 15 pikë nga 30 pikë sa është maksimalja e pikëve në këtë shtyllë. Ekzekutivi i Komunës qëndron mirë në 5 (pesë) nga 15 (pesëmbëdhjetë) indikatorë. Publikimi i detajeve biografike të Kryetari/esh dhe drejtorëve/eshave, kthimi i nivelit të përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, publikimi i politikave planifikuese dhe zhvillimore të komunës, publikimi i Planit të punës së Kryetarit të Komunës si dhe raportimi i drejtorëve në kuvendin e komunës si dhe komisionet, janë indikatorët që janë vlerësuar si plotësisht transparente gjatë vitit 2018.

Në 5 (pesë) indikatorë tjerë në këtë shtyllë, komuna e Pejës është vlerësuar si pjesërisht transparente gjatë vitit 2018. Mungesa e publikimit të procedurave të tërësishme në regjistrimin e stafit civil dhe profesional (nuk ka të dhëna pas shpalljes së konkursit, kush është pranuar, poentimi etj), komuna e Pejës nuk ka të publikuar në ueb faqen e komunës data bazën e kërkesave për qasjen në dokumente publike, nuk ka informacione të plota në ueb faqen e komunës në respektimin e plotë të legjisllacionit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal, si dhe vendimet e Kryetarit të Komunës janë të publikuara si përmbledhje e tërësishme, praktikë kjo që minimizon qasjen e publikut në vendimet e kryetarit.

Nga 15 indikatorët që ka kjo shtyllë, në 5 indikatorë vlerësues komuna e Pejës ka qenë plotësisht jo transparente gjatë vitit 2018. Komuna e Pejës ka dështuar në ofrimin e informacioneve për çështjet që ndërlidhen me integrimin në BE dhe ndikimet e procesit të till në nivel komunal, nuk ka pasqyruar në ueb faqen e komunës raportin e Kryetarit, Kryetari nuk ka raportuar në kuvendin e komunës dhe komisione sipas legjisllacionit në fuqi (raporti gjashtë mujor i punës), nuk ka informacione dhe takime të Kryetarit me qytetarët si dhe ka munguar një Rregullore komunale për adresimin e ngacmimeve seksuale.

Mungesa e publikimit të raportit të punës në ueb faqen e komunës minimizon qasjen e qytetarëve në informata mbi punën e ekzekutivit komunal dhe njëkohësisht kryetarin e komunës e bënë jo – llogaridhënës në raport me qytetarët e komunës së Pejës. Po ashtu, mungesa e politikave të brendshme për adresimin e ngacmimeve seksuale brenda personelit të komunës mbetet një nga pengesat serioze të kryetarit/esh të komunës në adresimin korrekt të ngacmimeve të mundshme seksuale që mund të ndodhin brenda administratës komunale.



“TRANSPARENCA FINANCIAR E KOMUNË”. Komuna e Pejës në transparencën financiare është vlerësuar me 9 pikë nga 16 pikë se edhe është maksimalja e vlerësimit në 8 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë. Nga 8 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë, komuna e Pejës është vlerësuar si plotësisht jo transparente në një nga indikatorët.


Komuna e Pejës në këtë shtyllë të vlerësimit, qëndron mirë në 6 (katër) nga 8 (tetë) indikatorët vlerësues. Mbatja e procesverbaleve për regjistrimin e propozimeve të qytetarëve për kërkesat buxhetore, informimi i qytetarëve për takimet e KPF-së, publikimi i informatave mbi të hyrat vetanake të komunës si dhe informimi për ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës, janë 4 (katër) nga indikatorët vlerësues që kanë qenë plotësisht transparente gjatë vitit 2018.

Komuna e Pejës gjatë vitit 2018 përkundër diskutimit të raporteve tre mujore financiare në kuvendin e komunës, nuk ka respektuar afatet ligjore të përcaktuara sipas ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit andaj gjatë kësaj periudhe është vlerësuar si pjesërisht transparente për shkak të vonesave kohore në raportimin e raporteve të tilla në kuvendin e komunës.

Komuna e Pejës, në këtë shtyllë është vlerësuar si plotësisht jo transparente në 3 (tre) indikatorë. Kjo komunë, ka dështuar në publikimin e një përmbledhjeje të përgjigjeve mbi statusin e kërkesave të qytetarëve në proceset e dëgjimeve buxhetore, të marra në forma dhe mekanizma tjerë gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore (mbajtjen dhe publikimin e procesverbaleve, se cilat nga kërkesat e qytetarëve janë inkorporu në planifikimet buxhetore). Po ashtu, komuna e Pejës nuk ka publikuar borxhin publik komunal si dhe nuk ka publikuar listën e pronave komunale të marra/dhëna me qira.

Mungesa e transparencës në marrjen/dhënien me qira të pronave nga komuna rrit mundësit e keqpërdorimit të aseteve publike dhe minimizon konkurrencën e palëve të interesuara në procesin konkurrues. Andaj, komuna duhet të shtoj përpjekjet e saj në rritjen e transparencës së dhënies/marrjes së pronave me qira, në publikimin e listës së pronave komunale si dhe listën e pronave të dhëna apo të marra me qira nga ana e komunës.

Transparenca financiare dhe përfshirja e qytetarëve në planifikimet buxhetore mbetet një nga problemet e buxhetimit gjithëpërfshirës. Derisa kjo komunë, në njërin anë ka avancuar në hartimin dhe publikimin e procesverbaleve nga



dëgjimet publike duke listuar kërkesat e qytetarëve për projeksione buxhetore, në anën tjetër nuk ka publikuar një përmbledhje të përgjigjeve mbi statusin e kërkesave të qytetarëve në proceset e dëgjimeve buxhetore. Kjo qasje, ulë transparencën e komunës në organizimin e dëgjimeve buxhetore si dhe ulë besimin reciprok komunë-qytetarë.



“TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN”. Gjatë vitit 2018, Komuna e Pejës ka marrë 23 pikë nga 32 pikë se edhe është maksimalja në këtë shtyllë të vlerësimit dhe mbetet shtylla e dytë si më transparente. Nga 16 indikatorë sa ka kjo shtyllë, komuna e Pejës në 9 (nëntë) indikatorë është vlerësuar si plotësisht transparente, në 5 (pesë) indikatorë është vlerësuar si pjesërisht transparente dhe në 2 (dy) indikatorë është vlerësuar si plotësisht jo-transparente.


Komuna e Pejës është vlerësuar si plotësisht transparente në 9 (nëntë) nga 16 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë. Krijimi i një mekanizmi për monitorimin dhe adresimin e ankesave të qytetarëve (intraneti), përdorimi i rrjeteve sociale në baza të rregullta, konsolidimi i Këshillave Lokal, njoftimi i publikut për takimet publike, publikimi i aktiviteteve në ballinën e ueb faqes etj., janë indikatorët që janë vlerësuar si plotësisht transparentë gjatë vitit 2018.

Gjashtë indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparent gjatë kësaj periudhe janë: mungesa e informatave të mjaftueshme në hapjen e të dhënave “Open Data”, mos publikimi i memorandumeve me OSHC-në në ueb faqen e komunës (publikimi vetëm në formë të lajmeve), informata parciale në ofrimin e shërbimeve nga drejtorit komunale (procedurat, kostot etj), mungesa e pasqyrimin të draft buxhetit të komunës si mundësi i qasjes së qytetarëve më informata gjatë procesit të dëgjimeve buxhetore si dhe mos organizimi i takimeve me OSHC në baza të rregullta, janë ndër indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparente në komunën e Pejës.

Krahas vlerësimit si pjesërisht transparente në 5 indikatorët vlerësues, komuna e Pejës është vlerësuar si tërësisht jo transparentë në 2 indikatorë. Mos hapja e një linje telefonike pa pagesë për qytetarët, mos përkthimi i materialeve në të gjitha gjuhët zyrtare, janë indikatorët që janë vlerësuar si plotësisht jo transparente gjatë vitit 2018.



TRANSPARENCA NË PRIZREN (LVV)



Prizren
76 pikë apo
64.40%

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM



40

29

Kuvendi i Komunës



30

15

Zyra e Kryetarit/es



16

13

Financat Komunale



32

19

Konsultimet me Publikun

Pikët maksimale

Pikët e arritura

Komuna e Prizrenit del të jetë komuna e katërt më transparente, me një nivel të transparencës prej 76 pikë nga 118 sa është maksimalja apo vetëm 64.40 %. Institucioni më transparent i Komunës së Prizrenit është shtylla e “Financave”, në të cilin kjo komunë është vlerësuar me 13 pikë nga 16 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë shtyllë. Ndërsa Komuna e Prizrenit është më pak transparente në shtyllën e Zyrës së Kryetarit/es ku është vlerësuar me 15 pikë nga 30 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë shtyllë.



“**TRANSPARENCA E KUVENDIT TË KOMUNËS**”. Komuna e Prizrenit gjatë periudhës vlerësuese të transparencës në këtë shtyllë ka arritur të akumulojë 29 pikë nga 40 pikë sa është maksimalja bazuar në 20 indikatorë të vlerësimit në këtë shtyllë. Nga 20 indikatorë vlerësues sa ka kjo shtyllë, 13 prej tyre janë vlerësuar me transparencë maksimale, tre nga indikatorët janë vlerësuar pjesërisht transparentë dhe në katër indikatorë në këtë shtyllë është vlerësuar plotësisht jo transparent.

Kuvendi i Komunës së Prizrenit gjatë vitit 2018 nuk ka qenë plotësisht transparentë në publikimin e agjendës dhe materi-

aleve të nevojshme për mbledhjet e kuvendit të komunës, ka siguruar mekanizëm në publikimin e rregulloreve komunale, ka informuar me kohë qytetarët për mbledhjet e kuvendit të komunës, ka publikuar organogramin e komunës, ka publikuar Planin e veprimit të transparencë, ka publikuar Planin e punës së kuvendit etj.

Kuvendi i Komunës së Prizrenit gjatë vitit 2018 nuk ka qenë plotësisht transparentë në publikimin e të dhënave biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të kuvendit të komunës, në publikimin e draft Rregulloret dhe planet e KK-së si dhe publikimin e Rregulloreve komunale. Komuna e Prizrenit, pos në publikimin e vendimeve të kuvendit të komunës, vazhdon të mos publikoj të gjitha Rregulloret komunale të cilat janë në fuqi dhe vazhdojnë të aplikohet nga ana e ekzekutivit komunal.

Komuna e Prizrenit gjatë vitit 2018 ka dështuar në ofrimin e informacioneve për qytetarët mbi procesin e ligj bërjes, politik bërjes dhe vendimmarrjes. Po ashtu, Kuvendi i Komunës ka dështuar në ofrimin e informacioneve të plota konkretisht biografjin e anëtarëve të kuvendit të komunës, ka dështuar në ofrimin e informatave për kontaktet e institucioneve publike të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shkollore, institucionet shëndetësore etj, ka dështuar të publikoj



linçet e videove të mbledhjeve të kuvendit të komunës. Kuvendi i Komunës ka dështuar edhe në publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendit të komunës për vitin 2018.

Me qëllim të rritjes së transparencës, Kuvendi i Komunës duhet të ofrojë në ueb faqen e saj zyrtare informata të detajuara mbi procesin e ligj bërjes, politik bërjes dhe vendimarrjes me qëllim të rritjes së mundësive ku qytetarët mund të adresojnë komente, sugjerime, propozime dhe rekomandime mbi procesin e hartimit të politikave nga ana e kuvendit të komunës, duhet të publikoj biografin e anëtarëve të kuvendit të komunës, të publikoj kontaktet e institucioneve tjera publike, të publikoj linçet e mbledhjeve si dhe të publikoj procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit të komunës.



"TRANSPARENCA E ZYRËS SË KRYETARIT/E". është vlerësuar me 15 pikë nga 30 pikë sa është maksimalja e pikëve në këtë shtyllë. Ekzekutivi i Komunës qëndron mirë vetëm në 3 (tre) nga 15 (pesëmbëdhjetë) indikatorë. Emërimi i koordinitorit për qasje në dokumente publike si dhe qasja në data-bazën me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre, raportimi i drejtorëve të drejtorive komunale në Kuvendin e Komunës si dhe publikimi i vendimeve të Kryetarit të Komunës në ueb faqen e komunës, janë tre nga indikatorët që janë vlerësuar si tërësisht transparente gjatë vitit 2018.

Nga 15 indikatorët që ka kjo shtyllë, në 3 indikatorë vlerësues komuna e Prizrenit ka qenë plotësisht jo transparente gjatë vitit 2018. Mungesa e pasqyrimin të Planit të punës së Kryetarit/res në ueb faqen e komunës, mungesa e hartimit të Rregullores komunale për ngacmimet seksuale si dhe mungesa e caktimit të një dite të veçantë për pritjen e qytetarëve nga Kryetari i Komunës janë indikatorët e vlerësuar si plotësisht jo transparent gjatë vitit 2018.

Në 9 (nëntë) indikatorë tjerë në këtë shtyllë, komuna e Prizrenit është vlerësuar si pjesërisht transparente gjatë vitit 2018. Pasqyrimi i mangët i detajeve biografike për disa drejtor të drejtorive komunale, pasqyrimi i mangët i informatave të plota mbi çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimi i procesit në nivel komunal, mos kthimi i plotë i përgjigjeve në qasje në dokumente publike, mos publikimi i tërësishtëm i politikave planifikuese dhe zhvillimore (p.sh Planit Zhvillimor Komunal), mos publikimi i mekanizimit përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe përcjellja e statusit të kërkesave të tilla, mungesa e respektimit të plotë të legjislacionit në përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal, publikimi i pjesshëm i raporteve të punës nga ana e drejtorive komunale (mos publikimi në tërësi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës), mos raportimi i kryetarit për punën gjashtë mujore në kuvendin e

komunës (raportimi vetëm për 100 ditëshin e qeverisjes) si dhe mos publikimi i gjitha detajeve në procesin e regrutimit të stafit në shërbimin civil dhe profesional në ueb faqen e komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparente në këtë shtyllë.



"TRANSPARENCA FINANCIARE E KOMUNËS". Kkomuna e Prizrenit në transparencën financiare është vlerësuar me 13 pikë nga 16 pikë sa edhe është maksimalja e vlerësimit në 8 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë. Nga 8 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë, komuna e Prizrenit është vlerësuar si plotësisht jo transparente në 1 (një) nga indikatorët.

Komuna e Prizrenit në këtë shtyllë të vlerësimit, qëndron mirë në 6 (gjashtë) nga 8 (tetë) indikatorët vlerësues. Publikimi i borxhit publik komunal, publikimi i listës së pronave komunale si dhe listës së pronave komunale të dhëna me qira, mbajtja e procesverbaleve për regjistrimin e propozimeve të qytetarëve për kërkesat buxhetore, informimi qytetarëve sipas legjislacionit për takimet e KPF-së, publikimi i informatave mbi të hyrat vetanake të komunës si dhe informimi për ndryshimet buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës, publikimi i të dhënave mbi të hyrat vetanake të komunës, janë 6 (gjashtë) nga indikatorët vlerësues që kanë qenë plotësisht transparente gjatë vitit 2018.

Komuna e Prizrenit gjatë vitit 2018 përkundër diskutimit të raporteve tre mujore financiare në kuvendin e komunës, nuk ka respektuar afatet ligjore të përcaktuara sipas ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit andaj gjatë kësaj periudhe është vlerësuar si pjesërisht transparente për shkak të vonësive kohore në raportimin e raporteve të tilla në kuvendin e komunës.

Komuna e Prizrenit, në këtë shtyllë është vlerësuar si plotësisht jo transparente në vetëm 1 (një) indikatorë. Derisa kjo komunë, në njërin anë ka avancuar në hartimin dhe publikimin e procesverbaleve nga dëgjimet publike duke listuar kërkesat e qytetarëve për projeksione buxhetore, në anën tjetër nuk ka publikuar një përmbledhje të përgjigjeve mbi statusin e kërkesave të qytetarëve në proceset e dëgjimeve buxhetore. Kjo qasje, ulë transparencën e komunës në organizimin e dëgjimeve buxhetore si dhe ulë besimin reciprok komunë-qytetarë.



"TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKU". Gjatë vitit 2018, Komuna e Prizrenit ka marrë 19 pikë nga 32 pikë se edhe është maksimalja në këtë shtyllë të vlerësimit. Nga 16 indikatorët sa ka kjo shtyllë, komuna e Prizrenit në 6 ind-



ikatorë është vlerësuar si plotësisht transparente, në 7 indikatorë është vlerësuar si pjesërisht transparente dhe në 3 (tre) indikatorë është vlerësuar si plotësisht jo-transparente.

Komuna e Prizrenit është vlerësuar si plotësisht transparente në 6 (gjashtë) nga 16 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë. Krijimi i një mekanizmi për monitorimin dhe adresimin e ankesave të qytetarëve (komuna ka të ndërtuar sistemin e intranetit për përcjelljen e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve), përdorimi i rrjeteve sociale në baza të rregullta, publikimi i kontakteve të zyrtarit për informim, njoftimi i publikut për takimet publike, publikimi i aktiviteteve në ballinën e ueb faqes si dhe qasja e qytetarëve në linjën telefonike pa pagesë, janë indikatorët që janë vlerësuar si plotësisht transparente gjatë vitit 2018.

Shtatë indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparent gjatë kësaj periudhe janë: mungesa e informatave për këshillat lokal (edhe përkundër konsolidimit), informata parciale nga ana e drejtorive komunale në ofrimin e shërbimeve (mungojnë informatat për procedurat, kostot etj), pak materialet përcjellëse në dëgjimet buxhetore, mungesa e materialeve në gjuhët zyrtare në nivel lokal, mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit (komuna e Prizrenit nuk ka organizuar takimin e dytë publik), mos publikimi i tërësishëm i raporteve nga konsultimet dhe dëgjimet buxhetore, mos organizimi në baza të rregullta i takimeve me organizatat e shoqërisë civile, janë ndër indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht jo transparentë në komunën e Prizrenit gjatë vitit 2018. Vlen të ceket se komuna e Prizrenit është komuna e vetme e cila gjatë këtij viti nuk ka organizuar takimin e dytë publik me qytetarë gjatë vitit 2018.

Krahas vlerësimit si pjesërisht transparente në 3 indikatorët vlerësues, komuna e Prizrenit është vlerësuar si tërësisht jo transparentë në hapjen e të dhënave statistikore "OPEN DATA", mungesa e informatave rreth memorandumeve të komunës me OSHC (as në formë të lajmeve) si dhe mos publikimi i raporteve për transparencë të realizuara nga akter të ndryshëm.






TRANSPARENCA NË SUHAREKË (AAK)



Suharekë
74 pikë apo
62.71%

VLERËSIMI I
PËRGJITHSHËM



Komuna e Suharekës del të jetë komuna e pestë më transparente në kuadër të komunave të cilat ishin pjesë e matjes së transparencës me 74 pikë nga 118 pikë së është maksimalja apo 62.71 % të nivelit të përgjithshëm bazuar në 59 indikatorë.

Komuna e Suharekës del të jetë komuna e pestë më transparente, me një nivel të transparencës prej 74 pikë. Institucioni më transparent i Komunës së Suharekës është shtylla e "Kuvendit të Komunës", në të cilin kjo komunë është vlerësuar me 31 pikë nga 40 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë shtyllë. Komuna e Suharekës është më pak transparente në shtyllën e Financave ku është vlerësuar me 7 pikë nga 16 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë shtyllë.



"TRANSPARENCA E KUVENDIT TË KOMUNËS". Komuna e Suharekës gjatë periudhës vlerësuese të transparencës në këtë shtyllë ka arritur të akumulojë 31 pikë nga 40 pikë sa është maksimalja bazuar në 20 indikatorë të vlerësimit në këtë shtyllë. Nga 20 indikatorë vlerësues sa ka kjo shtyllë, 14 prej tyre janë vlerësuar me transparencë maksimale, tre nga indikatorët janë vlerësuar pjesërisht transparente dhe në tre nga indikatorët në këtë shtyllë është vlerësuar si plotësisht jo transparente.

Komuna e Suharekës gjatë vitit 2018 ka qenë plotësisht transparente në këta indikatorë: publikimi i agjendës së takimeve dhe materialet e nevojshme për seancat e kuvendit të komunës, ka publikuar një data-bazë ku mund të sigurohet qasja në Rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyra e votimit, ka të specifikuar historikun në ballinën e ueb faqes zyrtare, ka bërë informimin në kohë të qytetarëve për takimet e caktuara të kuvendit të komunës, ka pasur komitetet e hapura për publikun, ka publikuar organo-gramin e komunës, ka publikuar Planin e veprimit për transparencë etj.

Kuvendi i Komunës së Suharekës gjatë vitit 2018 nuk ka qenë plotësisht transparentë në publikimin e të dhënave biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në publikimin e linçeve të videove të mbledhjeve të kuvendit në ueb faqen e komunës. Po ashtu, komuna e Suharekës vazhdon të mos publikoj tërësisht kontaktet e institucioneve publike të komunës të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shkollore, QKMF etj.

Kuvendi i Komunës së Suharekës edhe gjatë viti 2018 ka vazhduar me mungesë të transparencës duke mos ofruar informacione mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi këto procese, duke mos publikuar Planin e punës së Ku-





vendit si dhe duke mos publikuar draft Rregulloret dhe planet e Kuvendit të Komunës.



"TRANSPARENCA E ZYRËS SË KRYETARIT/ES". Kjo shtyllë është vlerësuar me 18 pikë nga 30 pikë sa është maksimalja e pikëve në këtë shtyllë. Ekzekutivi i Komunës është vlerësuar plotësisht transparent në vetëm 5 (pesë) indikatorë, në 8 (tetë) indikatorë është vlerësuar pjesërisht transparent dhe 2 (dy) indikatorë është vlerësuar si plotësisht jo transparentë.

Publikimi i detajeve biografike të Kryetarit dhe drejtorëve të drejtorive komunale, kthimi në kohë i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, publikimi i vendimeve të Kryetarit në ueb faqen e komunës si dhe praktika e takimit të qytetarëve (vizita javore) me kryetarin e komunës dhe publikimi i informacioneve mbi këto takime janë pesë nga indikatorët që janë vlerësuar si tërësisht transparente gjatë vitit 2018.

Në 8 (tetë) indikatorë tjerë në këtë shtyllë, komuna e Suharekës është vlerësuar si pjesërisht transparente gjatë vitit 2018. Mungesa e informatave të plota mbi çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimi i procesit në nivel komunal, mungesa e informatave të plota mbi publikimin e informatave në krejt procesin e regrutimit të stafit, mungesa e informatave të plota mbi publikimin e data-bazës lidhur me numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe trajtimi i tyre, mos publikimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), mos publikimi i raportit gjashtë mujor të punës në ueb faqen e komunës (është publikuar vetëm raporti 100 ditësh të punës së kryetarit), mungesa e realizimit të raportimit të kryetarit në kuvendin e komunës për periudhën gjashtë mujore (raportimi i punës vetëm për 100 ditëshin e punës së qeverisë) si dhe mungesa e respektimit të plotë të legjislacionit në përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal, janë indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparentë në këtë shtyllë.

Nga 15 indikatorët që ka kjo shtyllë, në 2 indikatorë vlerësues komuna e Suharekës ka qenë plotësisht jo transparente gjatë vitit 2018. Mungesa e pasqyrit të Planit të punës së Kryetarit/res në ueb faqen e komunës, mungesa e hartimit të Rregullores për ngacmimet seksuale janë indikatorët e vlerësuar si plotësisht jo transparent gjatë vitit 2018.



"TRANSPARENCA FINANCIAR E KOMUNËS". Komuna e Suharekës gjatë periudhës vlerësuese të transparencës në këtë shtyllë ka arritur të akumulojë 7 pikë nga 16 pikë sa është maksimalja bazuar në 8 indikatorë të vlerësimit në

këtë shtyllë. Nga 8 indikatorë vlerësues sa ka kjo shtyllë, 3 prej tyre janë vlerësuar me transparencë maksimale, 1 (një) nga indikatorët janë vlerësuar pjesërisht transparentë dhe në 4 (katër) nga indikatorë në këtë shtyllë është vlerësuar si plotësisht jo transparente.

Informimi i qytetarëve për pjesëmarrje në takimet e KPF-së, qasja në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara në kuvendin e komunës si dhe publikimi i të hyrave vetanake të komunës në ueb faqen e komunës janë 3 (tre) nga indikatorët vlerësues që kanë qenë plotësisht transparentë gjatë vitit 2018.

Komuna e Suharekës gjatë vitit 2018 përkundër diskutimit të raporteve tre mujore financiare në Kuvendin e Komunës, nuk ka respektuar afatet ligjore të përcaktuara sipas ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit andaj gjatë kësaj periudhe është vlerësuar si pjesërisht transparentë për shkak të vonesave kohore në raportimin e raporteve të tilla në kuvendin e komunës.

Komuna e Suharekës, në këtë shtyllë është vlerësuar si plotësisht jo transparente në 4 (katër) indikatorë. Kjo komunë, ka dështuar në evidentimin dhe regjistrimin e kërkesave dhe propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit komunal (mbajtjen dhe publikimin e procesverbaleve), nuk ka publikuar një përmbledhje të përgjigjeve mbi statusin e kërkesave të qytetarëve në proceset e dëgjimeve buxhetore (të marra në forma dhe mekanizma tjerë gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore). Po ashtu, komuna e Suharekës nuk ka publikuar borxhin publik komunal si dhe nuk ka publikuar listën e pronave komunale të marra/dhëna me qira.



"TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN". Gjatë vitit 2018, Komuna e Suharekës ka marrë 18 pikë nga 32 pikë se edhe është maksimalja në këtë shtyllë të vlerësimit. Nga 16 indikatorë sa ka kjo shtyllë, komuna e Prizrenit në 6 indikatorë është vlerësuar si plotësisht transparente, në 6 (gjashtë) indikatorë është vlerësuar si pjesërisht transparente dhe në 4 (katër) indikatorë është vlerësuar si plotësisht jo-transparente.

Komuna e Suharekës është vlerësuar si plotësisht transparente në 6 (gjashtë) nga 16 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë. Krijimi i një mekanizmi për monitorimin dhe adresimin e ankesave të qytetarëve (intraneti), përdorimi i rrjeteve sociale në baza të rregullta, konsolidimi i këshillave lokal, njoftimi i publikut për takimet publike, publikimi i aktiviteteve



në ballinën e ueb faqes, janë indikatorët që janë vlerësuar si plotësisht transparente gjatë vitit 2018.

Gjashtë indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparent gjatë kësaj periudhe janë: mungesa e informatave të mjaftueshme në hapjen e të dhënave "Open Data", mos publikimi i memorandumeve me OSHC-në në ueb faqen e komunës (publikimi vetëm në formë të lajmeve), mos publikimi i emrit të zyrtarit për informim në ueb faqen e komunës (vetëm publikimi i kontaktit të ZIP), mos publikimi i raporteve për transparencë në ueb faqen e komunës (komuna e Suharekës vetëm Raportin e Performancës ka të publikuar në ueb faqen e komunës), si dhe mos organizimi i takimeve me OSHC në baza të rregullta, janë ndër indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparente në komunën e Suharekës.

Krahas vlerësimit si pjesërisht transparente në 6 indikatorët vlerësues, komuna e Suharekë është vlerësuar si tërësisht jo transparente në 4 indikatorë. Mos hapja e një linje telefonike pa pagesë për qytetarët, mungesa e materialeve përcjellëse për qytetarët në dëgjimet publike dhe buxhetore, mos përkthimi i materialeve në të gjitha gjuhët zyrtare si dhe mos publikimi i raporteve nga konsultimet e publikut dhe dëgjimeve buxhetore janë indikatorët që janë vlerësuar si plotësisht jo transparente gjatë vitit 2018.



TRANSPARENCA NË DEÇAN (AAK)




Deçan
67 pikë apo
56.77%

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM




40



Kuvendi i Komunës



30



Zyra e Kryetarit/es




16



Financat Komunale



32



Konsultimet me Publikun

Pikët maksimale

Pikët e arritura

Komuna e Deçanit del të jetë komuna me më pak transparencë krahasuar me 5 komunat tjera që janë pjesë e këtij hulumtimi me vetëm 67 pikë nga 118 sa është maksimalja apo 56.77% bazuar në 59 indikatorë. Institucioni më transparent i Komunës së Deçanit është shtylla e "Kuvendit të Komunës", në të cilin kjo komunë është vlerësuar me 31 pikë nga 40 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë shtyllë. Komuna e Deçanit është më pak transparente në shtyllën e "Financave" ku është vlerësuar me vetëm 6 pikë nga 16 pikë sa është maksimalja e vlerësimit në këtë shtyllë..



"TRANSPARENCA E KUVENDIT TË KOMUNËS". Komuna e Deçanit gjatë periudhës vlerësuese të transparencës, në këtë shtyllë ka arritur të akumulojë 31 pikë nga 40 pikë sa është maksimalja bazuar në 20 indikatorë të vlerësimit në këtë shtyllë. Nga 20 indikatorë vlerësues sa ka kjo shtyllë, 14 prej tyre janë vlerësuar me transparencë maksimale, tre nga indikatorët janë vlerësuar pjesërisht transparente dhe në tre nga indikatorët në këtë shtyllë është vlerësuar si plotësisht jo transparente.

Komuna e Deçanit gjatë vitit 2018 ka qenë plotësisht transparente në këta indikatorë: publikimi i agjendës së takimeve dhe materialet e nevojshme për seancat e Kuvendit të Komunës,

ka publikuar një data-bazë ku mund të sigurohet qasja në Rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyra e votimit, ka të specifikuar në ballinën e ueb faqes zyrtare historikun e komunës, ka bërë informimin në kohë të qytetarëve për takimet e caktuara të kuvendit të komunës, ka pasur komitetet e hapura për publikun, ka publikuar organo-gramin e komunës, ka publikuar Planin e veprimit për transparencë etj.

Kuvendi i Komunës së Deçanit gjatë vitit 2018 nuk ka qenë plotësisht transparentë në publikimin e të dhënave biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve. Po ashtu, komuna e Deçanit vazhdon të mos publikojë tërësisht kontaktet e institucioneve publike të komunës të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shkollore, QKMF etj.

Kuvendi i Komunës së Deçanit edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar me mungesë të transparencës duke mos ofruar informacione mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi këto procese, duke mos publikuar linçet e videove të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës si dhe duke mos ofruar qasje në draft Rregulloret dhe planet tjera të shqyrtuara dhe miratuara nga ana e Kuvendit të Komunës.



|||||



ZYRA E KRYETARIT/ES. Komuna e Deçanit është vlerësuar me 12 pikë nga 30 pikë sa është maksimalja e pikëve në këtë shtyllë. Ekzekutivi i Komunës është vlerësuar plotësisht transparent në vetëm 4 (katër) indikatorë, në 4 (katër) indikatorë është vlerësuar pjesërisht transparent dhe 7 (shtatë) indikatorë është vlerësuar si plotësisht jo transparente.

Kthimi në kohë i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, publikimi i konkurseve për punësim dhe kriteret, raportimi i drejtorëve në Kuvendin e Komunës dhe komisione si dhe publikimi i vendimeve të Kryetarit në ueb faqen e komunës, janë pesë nga indikatorët që janë vlerësuar si tërësisht transparente gjatë vitit 2018.

Në 4 (katër) indikatorë tjerë në këtë shtyllë, komuna e Deçanit është vlerësuar si pjesërisht transparente gjatë vitit 2018. Mungesa e informatave të plota të biografive të drejtorëve të drejtorive komunale, mungesa e publikimit të data bazës për numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe trajtimi i tyre si dhe mungesa e një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe përcjellja e statusit të kërkesave për konsultimet dhe dëgjimet buxhetore janë indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparente në këtë shtyllë.

Nga 15 indikatorët që ka kjo shtyllë, në 7 (shtatë) indikatorë vlerësues, komuna e Deçanit ka qenë plotësisht jo transparente gjatë vitit 2018. Mungesa e pasqyrit të Planit të punës së Kryetarit/res në ueb faqen e komunës, mungesa e hartimit të Rregullores për ngacmimet seksuale, mungesa e pasqyrit të politikave planifikuese dhe zhvillimore të komunës, mungesa e realizimit të raportit të Kryetarit në Kuvendin e Komunës dhe komisione si dhe mungesa e respektimit të legjislacionit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel lokal, janë indikatorët e vlerësuar si plotësisht jo transparent gjatë vitit 2018.



“TRANSPARENCA FINANCIAR E KOMUNËS”. Komuna e Deçanit gjatë periudhës vlerësuese të transparencës në këtë shtyllë ka arritur të akumulojë 6 pikë nga 16 pikë sa është maksimalja bazuar në 8 indikatorë të vlerësimit në këtë shtyllë. Nga 8 indikatorë vlerësues sa ka kjo shtyllë, 3 prej tyre janë vlerësuar me transparencë maksimale, dhe në 5 (pesë) nga indikatorët në këtë shtyllë është vlerësuar si plotësisht jo transparente.

Informimi i qytetarëve për pjesëmarrje në takimet e KPF-së në forma tradicionale dhe forma tjera elektronike, qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara në Kuvendin e Komunës si dhe diskutimi i raporteve tre mujo-

re të shpenzimeve në Kuvendin e Komunës janë 3 (tre) nga indikatorët vlerësues që kanë qenë plotësisht transparente gjatë vitit 2018.

Komuna e Deçanit, në këtë shtyllë është vlerësuar si plotësisht jo transparente në 5 (pesë) indikatorë. Kjo komunë, ka dështuar në evidentimin dhe regjistrimin e kërkesave dhe propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit komunal (mbajtjen dhe publikimin e procesverbaleve), nuk ka publikuar një përmbledhje të përgjigjeve mbi statusin e kërkesave të qytetarëve në proceset e dëgjimeve buxhetore (të marra në forma dhe mekanizma tjerë gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore). Po ashtu, komuna e Deçanit nuk ka publikuar në ueb faqen e komunës borxhin publik komunal si dhe nuk ka publikuar listën e pronave komunale të marra/dhëna me qira.



“TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN”. Gjatë vitit 2018, Komuna e Deçanit ka marrë 18 pikë nga 32 pikë se edhe është maksimalja në këtë shtyllë të vlerësimit. Nga 16 indikatorë sa ka kjo shtyllë, komuna e Deçanit në 7 (shtatë) indikatorë është vlerësuar si plotësisht transparente, në 4 (katër) indikatorë është vlerësuar si pjesërisht transparente dhe në 5 (pesë) indikatorë është vlerësuar si plotësisht jo-transparente.

Komuna e Deçanit është vlerësuar si plotësisht transparente në 7 (shtatë) nga 16 indikatorët vlerësues në këtë shtyllë. Krijimi i një mekanizmi për monitorimin dhe adresimin e ankesave të qytetarëve (intraneti), përdorimi i rrjeteve sociale në baza të rregullta, konsolidimi i këshillave lokal dhe publikimi i kontakteve, njoftimi i publikut për takimet publike, publikimi i aktiviteteve në ballinën e ueb faqes, organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit në fuqi, publik janë indikatorët që janë vlerësuar si plotësisht transparente gjatë vitit 2018.

Katër nga indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparent gjatë kësaj periudhe janë: mos publikimi i memorandumeve me OSHC-në në ueb faqen e komunës (publikimi vetëm në formë të lajmeve), ofrimi i pjesshëm i listës së shërbimeve që ofrojnë drejtoritë komunale (mungojnë procedurat, kostot etj), mos publikimi i raporteve nga konsultimet me publikun dhe dëgjimet buxhetore (publikimi vetëm në formë të lajmeve), si dhe mos organizimi i takimeve me OSHC në baza të rregullta, janë ndër indikatorët që janë vlerësuar si pjesërisht transparente në komunën e Deçanit.

|||||



REKOMANDIMET

Komuna e Gjakovës

Kuvendi i Komunës:

- Të ofrojë inflamacione në ueb faqen e komunës mbi procesin e mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes
- Të publikojë të gjitha të dhënat dhe biografin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- Të publikojë kontaktet e institucioneve publike të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shëndetësore etj

Zyra e Kryetarit:

- Të publikohen në ueb faqen e komunës raportet e Kryetarit të Komunës (raportet periodike)
- Të hartohet një Rregullore komunale për ngacmimet seksuale
- Të respektohet legjislacioni për gjuhët zyrtare në nivel lokal

Transparenca Financiare:

- Të publikohet në ueb faqen e komunës lista e pronave komunale, pronat e marra/dhëna me qira nga Komuna
- Të publikohen informatat mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të dhëna nga qytetarët

Transparenca në Konsultime me Publikun:

- Të publikohen raportet për transparencë që realizohen/nxjerrën nga akterë të shoqërisë civile apo akterë tjerë institucional
- Të vazhdohet me hapjen e të dhënave statistiko-re "Open Data"
- Të publikohen në ueb faqen e komunës memorandumet e komunës me OSHC
- Të ofrohen nga drejtoritë komunale listat e ofrimit të shërbimeve për qytetarë duke përfshirë procedurën dhe koston e ofrimit të shërbimeve të tilla
- Të ofrohen materiale përcjellëse për qytetarët gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore (publikimi në ueb faqen e komunës të draft politikave buxhetore)
- Të përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare (sipas legjislacionit)

Komuna e Rahovecit

Kuvendi i Komunës:

- Të ofrojë informacione në ueb faqen e komunës mbi procesin e mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes
- Të publikojë të gjitha të dhënat dhe biografin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- Të publikojë kontaktet e institucioneve publike të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shëndetësore etj

Zyra e Kryetarit:

- Të raportohet në Kuvendin e Komunës për punën në baza të rregullta (çdo 6 muaj)
- Të hartohet një Rregullore komunale për ngacmimet seksuale
- Të publikohen politikat planifikuese dhe zhvillimorë në ueb faqen e komunës
- Të respektohet legjislacioni për gjuhët zyrtare në nivel lokal
- Të ofrohen informacione të rregullta mbi takimet e Kryetarit me qytetarë (takimet javore)

Transparenca Financiare:

- Të publikohet në ueb faqen e komunës lista e pronave komunale, pronat e marra/dhëna me qira nga Komuna
- Të publikohen informatat mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të dhëna nga qytetarët

Transparenca në Konsultime me Publikun:

- Të ofrohet një linjë direkte telefonike pa pagesë, në të cilin qytetarët mund të kontaktojnë me komunën
- Të vazhdohet me hapjen e të dhënave statistiko-re "Open Data"
- Të publikohen në ueb faqen e komunës memorandumet e komunës me OSHC
- Të ofrohen nga drejtoritë komunale listat e ofrimit të shërbimeve për qytetarë duke përfshirë procedurën dhe koston e ofrimit të shërbimeve të tilla
- Të ofrohen materiale përcjellëse për qytetarët gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore (publikimi në ueb faqen e komunës të draft politikave buxhetore)
- Të përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare (sipas legjislacionit)



Komuna e Pejës

brenda afateve ligjore të përcaktuara me ligjin për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit

Kuvendi i Komunës:

- Të ofrojë informacione në ueb faqen e komunës mbi procesin e mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes
- Të publikoj në ueb faqen e komunës organogramin
- Të publikojë në ueb faqen e komunës Planin e punës
- Të publikojë të gjitha të dhënat dhe biografin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës
- Të publikojë kontaktet e të gjitha institucioneve publike të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shëndetësore etj
- Të ofrojë qasje në të gjitha draft Rregulloret komunale dhe planet

Zyra e Kryetarit:

- Të publikohen informata për çështjet që ndërliohen me integritet në BE dhe ndikimi i procesit në komunë
- Të publikohet raporti i punës së Kryetarit në ueb faqen e komunës (raportet 6 mujore të punës)
- Të raportohet në Kuvendin e Komunës për punën në baza të rregullta (çdo 6 muaj)
- Të hartohet një Rregullore komunale për ngacmimet seksuale
- Të vendoset një ditë e veçantë për pritjen e qytetarëve dhe të publikohen informatat nga takimet e tilla me qytetarë
- Të publikohen të dhënat për procesin e tër-sishëm të regrutimit të stafit civil dhe profesional (jo vetëm publikimi i konkurseve dhe kriteret)
- Të publikohet data baza me numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe trajtimi i tyre (baza 3 mujore)
- Të praktikohet një mekanizëm që evidenton statusin në përgjigjet e komunës në raport me kërkesat e qytetarëve
- Të respektohet plotësisht legjislacioni për gjuhët zyrtare në nivel lokal
- Të publikohen në formatin adekuat vendimet e Kryetarit të Komunës

Transparenca Financiare:

- Të publikohet në ueb faqen e komunës borxhi publik komunal
- Të publikohet në ueb faqen e komunës lista e pronave komunale, pronat e marra/dhëna me qira nga Komuna
- Të publikohen informatat mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të dhëna nga qytetarët
- Të diskutohen raportet tre mujore financiare

Transparenca në Konsultime me Publikun:

- Të ofrohet një linjë direkte telefonike pa pagesë, në të cilin qytetarët mund të kontaktojnë me komunën
- Të përkthehet materiale në gjuhë zyrtare (sipas legjislacionit)
- Të vazhdohet me hapjen e të dhënave statistiko-re "Open Data"
- Të publikohen në ueb faqen e komunës memorandumet e komunës me OSHC
- Të ofrohen nga drejtorit komunale listat e ofrimit të shërbimeve për qytetarë duke përfshirë procedurën dhe koston e ofrimit të shërbimeve të tilla
- Të ofrohen materiale përcjellëse për qytetarët gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore (publikimi në ueb faqen e komunës të draft politikave buxhetore)
- Të organizohen takime me OSHC në baza të rregullta

Komuna e Prizrenit

Kuvendi i Komunës:

- Të ofrojë informacione në ueb faqen e komunës mbi procesin e mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes
- Të publikojë kontaktet e të gjitha institucioneve publike të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shëndetësore etj
- Të publikoj linçet e videove të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës
- Të publikoj procesverbalet e mbledhjeve
- Të publikoj për të gjithë anëtarët e kuvendit biografin dhe të dhënat tjera përcjellëse
- Të ofrojë qasje në të gjitha draft Rregulloret komunale dhe planet
- Të ofrojë qasje në të gjitha Rregulloret komunale

Zyra e Kryetarit:

- Të publikohen informata për çështjet që ndërliohen me integritet në BE dhe ndikimi i procesit në komunë
- Të publikohet në ueb faqe Plani i punës së Kryetarit
- Të vendoset një ditë e veçantë për pritjen e qytetarëve dhe të publikohen informatat nga takimet e tilla me qytetarë
- Të hartohet një Rregullore komunale për ngacmimet seksuale
- Të publikohen të gjitha biografin e drejtorëve komunal



- Të publikohen të dhënat për procesin e tërësishëm të rekrutimit të stafit civil dhe profesional (jo vetëm publikimi i konkurseve dhe kriteret)
- Të praktikohet një mekanizëm që evidenton statusin në përgjigjet e komunës në raport me kërkesat e qytetarëve
- Të respektohet plotësisht legjislacioni për gjuhët zyrtare në nivel lokal

Transparenca Financiare:

- Të publikohen informatat mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të dhëna nga qytetarët
- Të diskutohen raportet tre mujore financiare brenda afateve ligjore të përcaktuara me ligjin për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit

Transparenca në Konsultime me Publikun:

- Të hapen të dhënat statistikore "Open Data"
- Të publikohen në ueb faqen e komunës memorandumet e komunës me OSHC
- Të publikohen raportet për transparencë që realizohen/nxjerrën nga akterë të shoqërisë civile apo akterë tjerë institucional
- Të publikohen të dhënat e Këshillave Lokal
- Të ofrohen nga drejtorit komunale listat e ofrimit të shërbimeve për qytetarë duke përfshirë procedurën dhe koston e ofrimit të shërbimeve të tilla
- Të ofrohen materiale përcjellëse për qytetarët gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore (publikimi në ueb faqen e komunës të draft politikave buxhetore)
- Të organizohen takime me OSHC në baza të rregullta
- Të përkthehet materiale në gjuhë zyrtare (sipas legjislacionit)

Komuna e Suharekës

Kuvendi i Komunës:

- Të ofrojë informacione në ueb faqen e komunës mbi procesin e mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes
- Të publikohet Plani i punës
- Të publikoj për të gjithë anëtarët e kuvendit biografin dhe të dhënat tjera përcjellëse
- Të publikojë kontaktet e të gjitha institucioneve publike të atilla si: institucionet parashkollëre, institucionet shëndetësore etj
- Të ofrojë qasje në të gjitha draft Rregulloret komunale dhe planet
- Të publikoj linçet e videove të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Zyra e Kryetarit:

- Të publikohet në ueb faqe Plani i punës së Kryetarit
- Të hartohet një Rregullore komunale për ngacimet seksuale
- Të publikohen informata për çështjet që ndërlihen me integritet në BE dhe ndikimi i procesit në komunë
- Të publikohen të dhënat për procesin e tërësishëm të rekrutimit të stafit civil dhe profesional (jo vetëm publikimi i konkurseve dhe kriteret)
- Të publikohen të dhënat e Zyrtarit për Informim
- Të praktikohet një mekanizëm që evidenton statusin në përgjigjet e komunës në raport me kërkesat e qytetarëve
- Të publikohet në ueb faqen zyrtare raporti gjashtë mujor i punës
- Të raportohet në Kuvendin e Komunës në baza të rregullta raporti i punës
- Të publikohen të gjitha politikave planifikuese dhe zhvillimore
- Të respektohet plotësisht legjislacioni për gjuhët zyrtare në nivel lokal

Transparenca Financiare:

- Të publikohet në ueb faqen e komunës borxhi publik komunal
- Të publikohet në ueb faqen e komunës lista e pronave komunale, pronat e marra/dhëna me qira nga Komuna
- Të publikohen informatat mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të dhëna nga qytetarët
- Të praktikohen mbajtja e procesverbaleve në dëgjimet buxhetore dhe publikimi i tyre në ueb faqen e komunës
- Të diskutohen raportet tre mujore financiare brenda afateve ligjore të përcaktuara me ligjin për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit
- Të publikohen informatat mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të dhëna nga qytetarët
- Të diskutohen raportet tre mujore financiare brenda afateve ligjore të përcaktuara me ligjin për menaxhimin e financave dhe përgjegjësit

Transparenca në Konsultime me Publikun:

- Të ofrohen materiale përcjellëse për qytetarët gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore (publikimi në ueb faqen e komunës të draft politikave buxhetore)
- Të përkthehet materiale në gjuhë zyrtare (sipas legjislacionit)
- Të publikohen procesverbalet nga mbajtja e dëgjimeve buxhetore
- Të ofrohet një linjë direkte telefonike pa pagesë, në të cilin qytetarët mund të kontaktojnë me komunën





- Të hapen të dhënat statistikore "Open Data"
- Të organizohen takime me OSHC në baza të rregullta
- Të publikohen në ueb faqen e komunës memorandumet e komunës me OSHC
- Të publikohen gjitha raportet për transparencë që realizohen/nxjerrën nga akterë të shoqërisë civile apo akterë tjerë institucional
- Të ofrohen nga drejtorit komunale lista e ofrimit të shërbimeve për qytetarë duke përfshirë procedurën dhe koston e ofrimit të shërbimeve të till

Komuna e Deçanit

Kuvendi i Komunës:

- Të ofrojë informacione në ueb faqen e komunës mbi procesin e mbi procesin e ligj-bërjes, politik-bërjes dhe vendimmarrjes
- Të publikohen linçet e videove nga mbledhjet e kuvendit
- Të ofrojë qasje në të gjitha draft Rregulloret komunale dhe planet
- Të publikoj për të gjithë anëtarët e kuvendit biografën dhe të dhënat tjera përcjellëse
- Të publikojë kontaktet e të gjitha institucioneve publike të atilla si: institucionet parashkollore, institucionet shëndetësore etj
- Të publikoj linçet e videove të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës
- Të publikoj të gjitha procesverbalet e mbledhjeve

Zyra e Kryetarit:

- Të publikohen informata për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimi i procesit të komunë
- Të publikohen të gjitha politikat planifikuese dhe zhvillimore
- Të publikohet në ueb faqe Plani i punës së Kryetarit
- Të publikohet në ueb faqen zyrtare raporti gjashtë mujor i punës
- Të hartohet një Rregullore komunale për ngacimet seksuale
- Të raportohet në Kuvendin e Komunës në baza të rregullta raporti i punës
- Të respektohet plotësisht legjisllacioni për gjuhët zyrtare në nivel lokal
- Të publikohen të dhënat për gjithë drejtorët e drejtorive komunale
- Të praktikohet një mekanizëm që evidenton statusin në përgjigjet e komunës në raport me kërkesat e qytetarëve
- Të praktikohet vizita javore të qytetarëve për kryetarin e komunës si dhe të jepen informata rreth këtyre vizitave javore

Transparenca Financiare:

- Të publikohen të hyrat vetanake të Komunës
- Të publikohet në ueb faqen e komunës borxhi publik komunal
- Të publikohet në ueb faqen e komunës lista e pronave komunale, pronat e marra/dhëna me qira nga Komuna
- Të publikohen informatat mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të dhëna nga qytetarët
- Të praktikohet mbajtja e procesverbaleve në dëgjimet buxhetore dhe publikimi i tyre në ueb faqen e komunës
- Të publikohet borxhi publik komunal

Transparenca në Konsultime me Publikun:

- Të hapen të dhënat statistikore "Open Data"
- Të ofrohet një linjë direkte telefonike pa pagesë, në të cilin qytetarët mund të kontaktojnë me komunën
- Të ofrohen materiale përcjellëse për qytetarët gjatë procesit të organizimit të dëgjimeve buxhetore (publikimi në ueb faqen e komunës të draft politikave buxhetore)
- Të përkthehet materiale në gjuhë zyrtare (sipas legjisllacionit)
- Të publikohen raportet për transparencë që realizohen/nxjerrën nga akterë të shoqërisë civile apo akterë tjerë institucional
- Të publikohen në ueb faqen e komunës memorandumet e komunës me OSHC
- Të ofrohen nga drejtorit komunale lista e ofrimit të shërbimeve për qytetarë duke përfshirë procedurën dhe koston e ofrimit të shërbimeve të tilla.
- Të publikohen procesverbalet nga mbajtja e dëgjimeve buxhetore.
- Të organizohen takime me OSHC në baza të rregullta.





ANEKSET. INDIKATORËT DHE KOMENTET

Aneks 1: Indikatorët

SHTYLLA #KUVENDI I KOMUNES

1	A janë të publikuara agjenda e takimeve dhe të gjitha materialet e nevojshme (e.g. pikat e rendit të ditës)?
2	A ka një data-bazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit?
3	A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Asamblesë Komunale?
4	A ka një historik të shkurtër me të dhëna kyçe në ballinë të ueb faqes që shërben si njoftim me Komunën?
5	A mund të gjinden lehtë informacione mbi procesin e ligj bërjes, politik bërjes, dhe vendimmarrjes në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese?
6	A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar me rregulloren e Kuvendit?
7	A janë komitetet e hapura për publikun?
8	A mund të gjinden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë shëndetësore, etj.)
9	A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligjit (10 prej tyre)?
10	A e ka komuna të publikuar organo-gramin?
11	A ka pjesëmarrje të organizatave vëzhguese gjatë mbledhjeve?
12	A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës?
13	A ka KK plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik?
14	A janë të publikuara linqe të videove të mbledhjeve të kuvendit pas zhvillimit?
15	A ka qasje në draft rregulloret dhe planet e KK?
16	A ka qasje në procesverbale?
17	A ka qasje në rendin e ditës?
18	A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK?
19	A janë seancat e hapura për publik?
20	A transmetohet seancat e Kuvendit drejtpërdrejtë, nëse po në çfarë platforme?

Pikë maksimale 40



|||||

SHTYLLA #TRANSPARENCA NË ZYREN E KRYETARIT/ES

- 1 A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)
- 2 A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë?
- 3 A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët?
- 4 A ka koordinator/e për qasje në D.Z si dhe data-bazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre?
- 5 A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)?
- 6 Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në D. Publike?
- 7 A janë planet zhvillimore të Komunës të publikuara?
- 8 A është publik plani i punës të Kryetarit/res?
- 9 A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës?
- 10 A është realizuar raporti i i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione(raporti i punës 2 herë në vit)?
- 11 A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është e paraparë?
- 12 A ka komuna të hartuar një rregullore për ngacmime seksuale?
- 13 A është ueb faqja e qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës?
- 14 A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun?
- 15 A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res?

Pikë maksimale 30

SHTYLLA #FINANCAT E KOMUNES

- 1 A është publik borxhi publik komunal, borxhi i kompanive?
- 2 A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend?
- 3 A është publike lista e pronave të marra me qira nga Komuna?
- 4 A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit?
- 5 Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e komitetit për financa?
- 6 A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga Kuvendi Komunal?
- 7 A ka informata mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve?
- 8 A ka të dhëna mbi të hyrat vetanake të Komunës?

Pikë maksimale 16

|||||

SHTYLLA #KONSULTIMET PUBLIKE

- 1 Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve?
- 2 A është bërë hapja e të dhënave statistikore Open Data?
- 3 A ka, e si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumëve me OSHC?
- 4 A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta?
- 5 A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?
- 6 A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim?
- 7 A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët?
- 8 A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun?
- 9 A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore?
- 10 A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare?
- 11 A bëhen njoftimet për takime publike në forma tradicionale? Nëse po, në çfarë formash?
- 12 A janë organizuar takimet publike ashtu sic janë të parapara me ligj?
- 13 A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e ueb faqes?
- 14 A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile ose tjetër)?
- 15 A publikohen raportet nga konsultimet e publikun dhe dëgjimet për buxhet?
- 16 A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile?

Pikë kamsimale 32

Aneks 2: Transparometri komunal

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KUVENDIN E KOMUNËS	PRIZREN	PEJE	GJAKOVË	SUHAREKË	RAHOVEC	DECAN
Ueb-Faqe	A janë të publikuara agjenda e takimeve dhe të gjitha materialet e nevojshme (e.g. pikat e rendit të ditës)?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A ka një data-bazë, mekanizëm ku publikohen ose mund të sigurohet qasja në rregulloret e shqyrtuara, aprovuara dhe mënyrën e votimit?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A janë të publikuara të dhënat biografike, kontaktet dhe kompetencat e anëtarëve të Asamblesë Komonale?	1	1	1	1	1	1
Ueb-Faqe	A ka një historik të shkurtër me të dhëna kyçe në ballinë të ueb faqes që shërben si njoftim me Komunën?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A mund të gjinden lehtë informacione mbi procesin e ligj bërjes, politik bërjes, dhe vendimmarrjes në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi ato procese?	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	A është bërë informimi i qytetarëve për takime në kohën e caktuar me rregulloren e Kuvendit?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A janë komitetet e hapura për publikun?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A mund të gjinden lehtë kontaktet dhe të dhënat për institucionet publike të komunës (institucionet parashkollore, shtëpitë shëndetësore, etj.)	0	1	1	1	1	1
Ueb-Faqe	A janë mbajtur të gjitha seancat e rregullta të parapara me ligjit (10 prej tyre)?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A e ka komuna të publikuar organo-gramin?	2	0	2	2	2	2
Intervist /Fizikisht	A ka pjesëmarrje të organizatave vëzhguese gjatë mbledhjeve?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A e ka të publikuar Kuvendi planin e Punës?	2	0	2	0	2	2
Ueb-Faqe	A ka KK plan të veprimit për Transparencë dhe a është publik?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A janë të publikuara linqe të videove të mbledhjeve të kuvendit pas zhvillimit?	0	2	2	1	2	0
Ueb-Faqe	A ka qasje në draft rregulloret dhe planet e KK?	1	1	2	0	2	0
Ueb-Faqe	A ka qasje në procesverbale?	0	2	2	2	2	1
Ueb-Faqe	A ka qasje në rendin e ditës?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A ka qasje në rregullore dhe vendime të KK?	1	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe – Fizikisht	A janë seancat e hapura për publik?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A transmetohet seancat e Kuvendit drejtpërdrejtë, nëse po në çfarë platforme?	2	2	2	2	2	2

|||||

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË ZYREN E KRYETARIT/ES	PRIZREN	PEJE	GJAKOVË	SUHAREKË	RAHOVEC	DECAN
Ueb-Faqe	A janë të publikuara detajet biografike të Kryetarit/res dhe drejtorëve/eshave (email, nr. kontaktues, biografi etj)	1	2	2	2	2	1
Ueb-Faqe	A ekzistojnë informata për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë?	1	0	2	1	2	0
Ueb-Faqe	A janë konkurset e punësimit dhe kriteret të publikuara dhe transparente për qytetarët?	1	1	2	1	2	2
Ueb-Faqe	A ka koordinator/e për qasje në D.Z si dhe data-bazë me numrin e kërkesave dhe trajtimin e tyre?	2	1	2	1	2	1
Ueb-Faqe / Intervistë	A ekziston një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre (a është publike)?	1	1	2	1	1	1
Ueb-Faqe /Krekese	Si qëndron niveli i përgjigjeve për qasje në D. Publike?	1	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A janë planet zhvillimore të Komunës të publikuara?	1	2	2	1	1	0
Ueb-Faqe	A është publik plani i punës të Kryetarit/res?	0	2	2	0	2	0
Ueb-Faqe	A është publikuar raporti gjashtëmujori i punës?	1	0	0	1	2	0
Ueb-Faqe / Intervistë	A është realizuar raporti i i Kryetarit/res në Kuvend dhe komisione(raporti i punës 2 herë në vit)?	1	0	2	1	0	0
Ueb-Faqe / Intervistë	A zhvillohen raportimet e drejtorëve/eshave në kuvend dhe komisione siç është e paraparë?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe / Intervistë	A ka komuna të hartuar një rregullore për ngacmime seksuale?	0	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	A është ueb faqja e qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunës?	1	1	1	1	1	0
Ueb-Faqe	A janë vendimet e Kryetarit/res të Komunës publike dhe të qasshme për publikun?	2	1	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A ka informacione nga vizitat javore të Kryetarit/res?	0	0	2	2	1	0

|||||

|||||

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA FINANCIARE	PRIZREN	PEJE	GJAKOVË	SUHAREKË	RAHOVEC	DECAN
Ueb-Faqe.	A është publik borxhi publik komunal, borxhi i kompanive?	2	0	2	0	2	0
Ueb-Faqe	A janë mbajtur diskutime brenda afateve ligjore mbi shpenzimet tre-mujore në Kuvend?	1	1	2	1	2	2
Ueb-Faqe	A është publike lista e pronave të marra me qira nga Komuna?	2	0	0	0	0	0
Ueb-Faqe	A ka një mekanizëm që shënon regjistrimin e propozimeve të qytetarëve rreth buxhetit?	2	2	2	0	2	0
Ueb-Faqe / Fizikisht	Si informohen qytetarët për pjesëmarrje në takimet e komitetit për financa?	2	2	2	2	2	2
Kërkesë Zyrt/Ueb-Faqe	A ka qasje në informata rreth ndryshimeve buxhetore të miratuara nga Kuvendi Komunës?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A ka informata mbi përgjigjet e komunës ndaj kërkesave buxhetore të qytetarëve?	0	0	1	0	0	0
Ueb-Faqe	A ka të dhëna mbi të hyrat vetanake të Komunës?	2	2	2	2	2	0

|||||

|||||

MËNYRA E MATJES	TRANSPARENCA NË KONSULTIME ME PUBLIKUN	PRIZREN	PEJE	GJAKOVË	SUHAREKË	RAHOVEC	DECAN
Kërkesë Zyrt/Ueb-Faqe	Si është bërë dhe si është monitoruar adresimi i ankesave të qytetarëve?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A është bërë hapja e të dhënave statistikore Open Data?	0	1	1	1	1	0
Ueb-Faqe	A ka, e si mund të gjinden informata rreth publikimeve të memorandumëve me OSHC?	0	1	1	1	1	0
Ueb-Faqe	A përdor Komuna rrjete sociale në baza të rregullta?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?	1	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A janë të publikuara kontaktet e zyrtarit/res dhe zyrës për informim?	2	2	2	1	2	2
Ueb-Faqe	A ka një linjë direkte pa pagesë për qytetarët?	2	0	2	0	0	0
Ueb-Faqe	A ekziston një listë e hollësishme të shërbimeve që institucionet ofrojnë për publikun?	1	1	1	1	1	1
Ueb-Faqe / Intervistë	A ka materiale përcjellëse për qytetarët për dëgjimet publike dhe buxhetore?	1	1	1	0	1	0
Ueb-Faqe / Intervistë	A përkthehen materialet në të gjitha gjuhët zyrtare?	1	0	1	0	1	0
Ueb-Faqe / Intervistë	A bëhen njoftimet për takime publike në forma tradicionale? Nese po, ne çfarë formash?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A janë organizuar takimet publike ashtu sic janë të parapara me ligj?	1	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A bëhet publikimi i aktiviteteve në ballinën e ueb faqes?	2	2	2	2	2	2
Ueb-Faqe	A publikohen raportet për transparencë (të realizuara për komunën përkatëse nga akterë të tjerë të shoqërisë civile ose tjetër)?	0	2	0	1	2	0
Ueb-Faqe / Intervistë	A publikohen raportet nga konsultimet e publikun dhe dëgjimet për buxhet?	1	2	2	0	2	1
Ueb-Faqe / Intervistë	A organizohen takime me organizata të shoqërisë civile?	1	1	2	1	1	1

|||||

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

364.14(496.51)"2018"

Transparometri komunal : Prizren, Pejë, Gjakovë, Suharekë,
Rahovec, Deçan : janar - dhjetor 2018 / përgaditur nga Naim
Cahanaj. – Prishtinë : Instituti Demokratik i Kosovës, 2019. –
39 f. : ilustr. ; 21 cm.

1.Cahanaj, Naim

ISBN 978-9951-745-21-5

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org



This publication is part of the project **Civic Involvement for Transparency and Accountability**, implemented by **Kosova Democratic Institute**, financed by Olof Palme International Center supported by Sëedish Government. Content of this publication reflects author's opinions and not necessarily Olof Palme International Center opinions.

